

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration


Për :	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së.	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 11/06/2019
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Vitisë	020-674
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi nr. 01-110/05-619 për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim
E miratuar më datë më datë: 03.06.2019
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.06.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Za:	Sokol Haliti, gradonačelnik Opštine Vitina Naïm Pira, predsedavajući Skupštine opštine Vitina	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština-MALS	
Preko:	Adriajna Hodžić, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u.	
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 11.06.2019
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Vitina	Br.020-674
Vrsta akta:	Odluka	

Uvaženi gradonačelnice,
 Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine, na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku.

Odluka br. 01-110/05-619 za formiranje komisije za procenu i sprovođenje procedura za davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine
Usvojena dana, 03.06.2019. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 10.06.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je sa proceduralnog aspekta u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi, i kao takav može prouzvesti prvni efekat.
 Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, neni 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 17, pika 3 lidhur me pikën 6 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji Nr.06/L-092, neni 36.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 03.06.2019, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e komisionit për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Vitisë. Komisioni ka 5 (pesë) anëtarë, dy nga ekzekutivi, dy nga Kuvendi i Komunës dhe një nga Shoqëria civile, dhe atë:

- Fadil Hoxha, anëtar i komisionit, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi.
- Shtetki Aliu, anëtar i komisionit, Drejtoria për Financa.
- Taibe Ibrahim, anëtar i komisionit nga LDK-ja
- Seidi Enini, anëtar i komisionit nga VV-ja
- Nurie Bajrami, anëtar i komisionit nga shoqëria civile

Neni 2

Detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi, janë përcaktuar në Ligjin për Dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me nr.10, të datës 03.04.2019). Komisioni vlerësoi udhëheq me procedurat mbi dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, si: përgatiti kriteret e ankandit, përcaktoi çmimin fillestar, vlerësoi ofertat dhe ja propozon kuvendit oferte mja të favorshme. Njësit përkatse të administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit; Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi; Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi për Formimin e Komisionit për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, me vendimin Nr.01-410-0356, të datës 02.02.2018.

Neni 5

Ky vendim hyrë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal në kuqim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008), neni 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrative të akteve të komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Kadastër,
3. Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
4. Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESËLISI

Natije Pira

[Signature]